



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:280125
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749670

Ac.nr.2660/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar, Kujtim Pasuli dhe Malsor Kryeziu-anëtarë në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses V.P nga Fushë Kosova rr”...” nr... të cilën e sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura M.B.N sh.p.k me përfaqësues M.S, B.S dhe N.S që të tre avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K.S” ...” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M menaxher i përfaqësimeve ligjore pranë Kompanisë, me objekt kontesti zhvendim, vlera e kontestit 5.400-€, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.594/19, të datës 17.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.05.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës K.S “...” me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.549/19 të datës 17.01.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.549/19, i datës 17.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.549/19 të datës 17.01.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditëses V.P nga Fushë Kosova rr”...” nr..., si e bazuar, dhe DETYROHET e paditura K.S ”...” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të dëmit jomaterial dhe material të shkaktuar me rastin e aksidentit të datës 29.10.2019, ashtu që në afat prej 15 dite nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, t’ia kompensoj shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo material t’ia paguaj shumën si vijon:

- për dhimbje fizike shumën prej 1.200.-€,
- Për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1000-€.

Në emër të dëmit material t’ia paguaj shumën si vijon:

- Për shkak të ushqimit të përforcuar shumën prej65.00.-€,
- Në emër të përkujdesit nga personat e tretë shumën prej57.00 €,

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi dt.17.01.2022, e deri te pagesa përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 708.40-€, e të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. II.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara sikurse në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë, në emër të kompensimit për dhimbjet fizike shumë prej 3.000-€, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2.000-€, në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit tjetër shumë prej 100.00-€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej,100.00-€, si dhe refuzohet në tërësi pjesa e kërkesëpadisë për sa i përket kërkesës në emër të rehabilitimit klimaterik në shumë prej 200.00-€, si të PABAZUARA.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar e paditura KS "...", për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe të gjykoj shumë më të ulët të kompensimit.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurës KS "...” për kompensim dëmi si pasojë e aksidentit të datës 29.10.2019.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj pjesërisht si të bazuar, duke vendosur më detalisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim mes tjerash ka theksuar se: me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1 i LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar etj. Mbi bazën e kësaj gjendjeje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditëses me rastin e lëndimeve të shkaktuara gjatë aksidentit, për çka e paditura është e obliguar që paditësit t’ia kompensoj dëmin si në dispozitiv të aktgjykimit, e në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e padituri mbi bazën e përgjegjësisë në bazë të fajit konform nenit 136, 159, 169 dhe 398 të LMD-së. Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditëses, e në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata e miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim real dhe objektiv dhe me bindjen se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit, e cila do t’i mundësoj të dëmtuarës këtu paditëses, satisfaksion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë ti kompensojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ajo do ta kishte poqëse të njëjtën nuk do ta kishte humbur, e tërë kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimisë. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumë e kompensimit të këtij dëmi mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirave dhe qëllimit të cilit i

shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin të mos u shkoj për shtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror. Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfikacion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuarat të paditëses me rastin e shkakimit të dëmit gjatë aksidentit, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deritanishme të Gjykatave të Kosovës. Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh, natyrën e lëndimit, sidomos sa i përket natyrës dhe kohëzgjatjes së dhimbjeve dhe intensitetin e frikës, për paditësen, e duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit sidomos moshën e të dëmtuarës, praktikën e mirë gjyqësore, (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar. Vlerësimi i gjykatës për këto kategori dëmi i referohet vlerësimin specifik që i ka bërë gjykata secilës kërkesë të paditëses duke u mbështetur në ekspertizën mjekësore dhe atë sa i përket kohëzgjatjes dhe intensitetit të dhimbjeve fizike si dhe intensitetit dhe mënyrës së si është manifestuar frika tek paditësja pas aksidentit. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumata e aprovuara, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë dhe se lartësia e kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me natyrën e lëndimeve, pasojat e lëndimeve dhe provat e administruara (mendimi i ekspertëve mjekësor), andaj gjykata të njëjtat i refuzoi nga se konsideroi se shumata e kërkuar mbi shumën e aprovuar mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarit të silltet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Gjykata ka vlerësuar se kërkesa e paditëses për shpenzime të rehabilitimit klimaterik është e pa bazuar, nga se paditësja për këtë pjesë të kategorisë se shpenzimeve nuk i ka prezentuar gjykatës prova shpresore respektivisht fatura relevante për shfrytëzimin e këtij lloji të tretmanit bazuar në ekspertizën mjekësorë të datës 12.10.2021. Gjykata në këtë rast ka vlerësuar edhe thëniet e palës së paditur, mirëpo meqë e paditura nuk e kontestoi bazën juridike të kërkesëpadisë, por vetëm lartësinë e saj, gjykata vërtetoi se e paditura me asnjë provë nuk arriti ta argumentojë të kundërtën nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me arsyetimet e dhëna më lartë. Gjykata përveç kërkesës kryesore paditëses ia ka pranuar edhe të drejtën në kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, duke llogaritur nga dt. 17.01.2022, dita kur është marrë aktgjykimi, e deri ne pagesën definitive, kjo bazuar në dispozitat e nenit 382 par. 2 të LMD-së nr. 04/L-077, ngase e paditura ka rënë në dijeni për obligimet ndaj paditëses në ditën e marrjes së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi në nenet 449 dhe 452.1 të LPK-së, me ç' rast paditësit në emër të shpenzimeve procedurale ia pranoi shumën e përgjithshme prej 614.00-€, bazuar në shumën e kërkesës se aprovuar, dhe faktin se në këtë procedurë pala paditëse e ka fituar kontestin në pjesën më të madhe, duke i kërkuar shpenzimet e procedurës, gjykata në mbështetje të dispozitave të lartshënuara dhe dispozitave të nenit 452.3 dhe 453.1 dhe 453.2 të LPK-së, si dhe konform rregullores së TOAK-së nr.04/L-193 për avokatinë të dt. 18.03.2017, e detyrojë të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë që kanë të bëjnë të bëjnë në përpilimin e padisë shumën prej 104-€, për 2 seanca gjyqësore të përfaqësuar nga avokati i palës paditëse nga 135.20-€x2=270.40-€, për ekspertizë mjekësore shumën prej 200-€, si dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30-€, në përputhje me udhëzimin administrativ mbi unifikimin e taksave gjyqësore të KGJK-së me nr. 01/2017 të dt. 15.03.2017, e të gjitha që arrijnë shumën prej 708.40-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti që është vendosur si në pikën I, dhe II të dispozitivit të aktgjykimit. Mbi bazën e të lartshënuarave dhe konform nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas Gjykatës së Apelit një pretendim i tillë i të paditurës rezulton i pa bazuar, sepse gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje kontestimore, ka administruar provat dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me prova bindëse, përfshirë këtu edhe ekspertizat e ekspertëve mjekësor Dr.A.F ortoped-traumatolog dhe Dr. N.M -psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional duke u bazuar në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e paditëses dhe shumat e gjykuara janë në harmoni me cenimin e të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, që me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Kompensimi i dëmit të pësuar paraqet satisfaksion për dëmin përkatësisht lëndimet e pësura e nuk ka për qëllim pasurimin e personit i cili ka pësuar dëm.

Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës se shumat e aprovuara janë të larta dhe nuk përkojnë me lëndimet e pësura dhe praktikën gjyqësore në rastet e ngjashme, sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale gjithmonë duke pas parasysh cenimin e të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim por edhe për atë që të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se me rastin e vendosjes për dëmin material gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mungesë të provave materiale për shkak se këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar me ekspertizën e ekspertit të ortopedisë dhe provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2660/22, me datë 27.05.2024

Numri i lëndës: 2019:280125
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749670

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v